



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 8/147

Datë: 05.10.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 tetor 2010, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 50.000,00 (pesëdhjetëmijë) euro në muaj për periudhë njëvjeçare për Kompaninë Ndërkombëtare PATTON, BOGGS, LLP, me seli në Uashington D.C. me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së interesave të Republikës së Kosovës jashtë vendit.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e paparashikuara, kodi organizativ 232, kategoria ekonomike e Rezervës dhe transferohen në këtë projekt.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë